



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

Kërkesë për shprehje të interesit

Data: Gusht 21, 2024

Vendi: Kosova

ID e Projektit: P171098

Ref. Nr.: SAS.1.1.ICS.009

Emri i Kreditit të Bankës Botërore: Projekti për Reformën e Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë

Konsulentë të Punësimit

Angazhimi i 40 konsulentëve të punësimit për të rritur kapacitetin e Zyrave të Punësimit për zbatimin e Programit Pilot për Aktivizimin e përfituesve të SAS në të gjitha komunitatet në Kosovës

REF: SAS.1.1.ICS.009

HISTORIKU

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në Republikën e Kosovës ka marrë një kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 47 milionë eurosh për financimin e Projektit për Reformën e Sistemit të Ndhmës Sociale të Kosovës. Qëllimi i projektit është përmirësimi i drejtësisë dhe përshtatshmërisë së rrjetit të mbrojtjes sociale të Kosovës.

Përmirësimi i ekuitetit do të përfshijë përzgjedhjen e përfituesve të SAS bazuar në statusin e varfërisë. Përmirësimi i përshtatshmërisë ka të bëjë me rritjen e kapacitetit të rrjetit të mbrojtjes sociale të Kosovës për t'iu përgjigjur ndryshimeve në nivelet e varfërisë në Kosovë si dhe goditjeve, përfshirë ato të shkaktuara nga klima, me qëllim të minimizimit të tendencave negative në nivelet e varfërisë së familjeve. Në maj të vitit 2024, MFPT kishte filluar procesin e pilotimit të një mjeti të ri për identifikimin e familjeve të varfra që kanë të drejtë për mbështetje SAS.

Në vazhdim, reforma do të avancojë metodat e ndërveprimit ndërmjet Qendrave për Punë Sociale (QPS) dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), e cila është përgjegjëse për koordinimin e shërbimeve të punësimit për përfituesit e SAS. Kjo reformë do të shoqërohet me

mbështetje për integrimin e përfituesve të SAS në tregun e punës. Kombinimi i këtyre faktorëve do të rrisë kërkesën për shërbimet e ofruara nga APRK dhe do të kërkojë përmirësimin e koordinimit ndërmjet QPS-ve dhe APRK-së.

Në këtë kontekst, MFPT synon të punësojë 40 këshilltarë të punësimit (të shpërndarë në të gjitha komunat e Kosovës) për një periudhë 12-mujore për të rritur kapacitetin e Zyrave të Punësimit gjatë zbatimit të Programit Pilot për Aktivizimin e përfituesve të SAS, si pjesë e planeve të Qeverisë për reformën e SAS. Programi Pilot për Aktivizimin do të zbatohet në koordinim me Skemën e Garancisë për të Rinj.

QËLLIMI I DETYRËS

Qëllimi kryesor i kësaj detyre është mbështetja e Zyrave të Punësimit në zbatimin e programit pilot në mbarë vendin për aktivizimin e përfituesve të SAS që janë të aftë për punë, në bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale.

FUSHËVEPRIMI

Këshilltarët e punësimit do të punojnë ngushtë me drejtorin e Zyrave të Punësimit dhe së bashku do të avancojnë rezultatet e përcaktuara në Termat e Referencës (ToR). Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të drejtorit të Zyrës së Punësimit, detyrat specifike që pritet nga ky këshillim përfshijnë:

1. Propozimin dhe zhvillimin e një plani për integrimin e përfituesve të ndihmës sociale në tregun e punës dhe monitorimin/azhurnimin e tij duke vendosur objektiva për t'u arritur brenda 6 muajve.
2. Zbatimi dhe koordinimi me Zyrat e Punësimit të udhëzimeve operationale për aktivizimin e përfituesve të SAS në tregun e punës;
3. Zbatimi i procesit të aktivizimit në tregun e punës për të papunët në bashkëpunim me Zyrat e Punësimit dhe Qendrat për Punë Sociale;
4. Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për aplikantët në lidhje me mundësitë e tyre të punësimit dhe adresimi i çështjeve të tjera që lidhen me punësimin.
5. Kryerja e procesit të përshtatjes sipas kërkesave dhe udhëzimi i përfituesve të Programit Pilot SAS drejt mundësive të përshtatshme të punës.
6. Identifikimi i sfidave kryesore me të cilat përballen të papunët në integrimin në tregun e punës duke kryer intervista të thelluara dhe regjistrimi dhe dokumentimi i shërbimeve të ofruara për përfituesit e Programit Pilot SAS.
7. Mbajtja e komunikimit të rregullt me përfituesit e Programit Pilot SAS, të paktën çdo dy javë, dhe dokumentimi i kërkimeve individuale për punë.
8. Udhëzimi i përfituesit të Programit Pilot SAS në masat ekzistuese ALMM (Masat e Aktivizimit në Tregun e Punës) dhe masën "Aktivizimi me Mbështetje", sipas nevojave dhe kriterëve të masave.
9. Ndihma e stafit të Zyrës së Punësimit në kontaktimin me biznese dhe punëdhënës të tjerë për të mbledhur informacione mbi vendet e punës.

10. Organizimi i vizitave monitoruese për të mbikëqyrur zbatimin e masave ekzistuese ALMM (Masat e Aktivizimit në Tregun e Punës) dhe masës "Aktivizimi me Mbështetje", dhe përpunimi i gjithë dokumentacionit për ekzekutimin e suksesshëm të masës.

11. Verifikimi i kritereve lidhur me aftësinë për punë dhe detyrimet e ndërsjella dhe përgatitja e raporteve mbi çdo problem të hasur.

12. Pjesëmarrja aktive në seminare dhe seanca trajnuese, si dhe kryerja e detyrave të tjera që lidhen me planin e aktivizimit.

REZULTATET

Këshilltarët e punësimit të përzgjedhur do të dorëzojnë:

- Informacion të përmbledhur mbi statusin e të gjithë përfituesve të Programit Pilot SAS të regjistruar në Zyrat e Punësimit çdo dy javë.
- Raporte mujore, ndërmjetëse dhe vjetore

KOHËZGJATJA DHE GRAFIKU I PAGESËS

- Detyra pritet të zgjasë 12 muaj (tetor 2024 – shtator 2025).
- Këshilltarët e punësimit do të paguhen çdo muaj me një tarifë prej 561 EUR (paga bruto, përfshirë të gjitha kontributet e pensionit dhe taksat).
- Këshilltarët e punësimit pritet të kenë një prani të rregullt fizike në Zyrën e caktuar të Punësimit gjatë periudhës së kontratës.

KUALIFIKIMET

Këshilltarët e punësimit duhet të jenë në gjendje të plotësojnë profilin dhe specifikimet e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkencat sociale, ekonomi ose drejtësi.
- Të paktën një (1) vit përvojë pune. Përparësi do të kenë ata me përvojë në sektorin e punësimit dhe zhvillimin e aftësive.
- Njohuri për tregun e punës në Kosovë, aftësitë e kërkuara në treg, vendet e punës të lira dhe kërkesat për tu pranuar në ato pozita pune.
- Njohja e gjuhës shqipe dhe/ose njërës nga gjuhët zyrtare të punës të komunës përkatëse.
- Gatishmëria për të punuar në Zyrat e Punësimit brenda të njëjtit rajon, në varësi të nevojave të Zyrave të Punësimit

DOKUMENTET E NEVOJSHME

- CV
- Dëshmi për kualifikimet (diplomat dhe certifikatat)
- Letër motivimi – maksimumi një faqe (duke treguar gjithashtu rajonin e preferuar për caktim)

- Dëshmi për përvojën e punës (referenca, kontrata ose deklaratë e besueshme)
- Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacione që tregojnë se ata kanë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të kryer shërbimet.

MARRËDHËNIET DHE DETYRIMET E RAPORTIMIT

Këshilltarët e punësimit do të raportojnë te drejtori i Zyrave të Punësimit në APRK. Një kopje elektronike e raportit duhet të dërgohet te Drejtori i Departamentit të Skemës Sociale dhe koordinatori i Njësisë së Koordinimit të Projektit.

Kriteret e vlerësimit janë:

Përshkrimi	Pikë
Kualifikimet e përgjithshme	40 pikë
Përvojë në detyra të ngjashme	60 pikë
	100 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar është paraqitur në Paragrafin VII, paragrafët 7.34, 7.35, 7.36 dhe 7.37 të “Rregulloreve të Prokurimit për Huamarrësit e IPF” të Bankës Botërore, Korrik 2016 (“Rregulloret e Prokurimit”), që përcaktojnë politikën e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit. Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e Konsulentit Individual (IC) sipas rregullimeve të Marrëveshjes Kornize të përkrahura në Rregulloret e Prokurimit dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit të përmendura më sipër.

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar, dmth. nga ora 08:00 deri në 16:00.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në version elektronik në adresën e mëposhtme (me e-mail) **deri të mërkurën, më Shtator 04 2024, deri në orën 16:00**, dhe duhet të përfshijnë:

- CV
- Dëshmi për kualifikimet (diplomat dhe certifikatat)
- Letër motivimi – maksimumi një faqe (duke treguar gjithashtu rajonin e preferuar për caktim)
- Dëshmi për përvojën e punës (referenca, kontrata ose deklaratë e besueshme)

Projekti i Reformës së Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë (SAS)

Njësia e Koordinimit të Projektit – PCU

Rruga UÇK, Nr.1, Qafa, 10 000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: procurement.SAS@rks-gov.net